



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

Lënda: Kthim përgjigje.

I S P

D.T.

E nderuar {...}!

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e Institutit të Studimeve Politike, në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion të datës 01.06.2021, regjistruar me numër rendor 25, datë 01.06.2021, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2523 Prot., datë 01.06.2021, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Neni 147 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Ndërsa ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikon në mënyrë të detajuar procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku në nenin 7 të tij përcaktohet se gjashtë anëtarët gjyqtarë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve, nga të cilët tre prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të shkallës së parë dhe së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë jashtë Tiranës, dy prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të apelit dhe së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të apelit jashtë Tiranës, një prej të zgjedhurve është gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Ndërsa lidhur me procedurën e përzgjedhjes së tyre, dispozitat e ligjit parashikojnë se Kryetari i Gjykatës së Lartë shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga gjyqtarët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jo më vonë se 4 muaj nga data e mbarimit të mandatit të anëtarëve gjyqtarë në detyrë, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe i dërgohet të gjithë gjyqtarëve në adresën elektronike zyrtare. Për verifikimin e plotësimit të kriterëve nga kandidatët ngarkohet Gjykata e Lartë, e cila në përfundim të këtij procesi shpall zyrtarisht kandidaturat në faqen zyrtare të saj.

Jo më vonë se dy muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, Kryetari i Gjykatës së Lartë thërret Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, për të zgjedhur anëtarët e Këshillit. Procesi i votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor është i hapur për mediat dhe të gjithë

vëzhguesit e tjerë që shprehin interes, pas marrjes së autorizimit paraprak nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Për administrimin e procesit të votimit krijohet komisioni i votimit, i përbërë nga tre ndihmësmagjistratë të Gjykatës së Lartë, të zgjedhur me short. Në përfundim të procesit të votimit zgjidhen fitues kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave.

Ndërsa në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve jogjyqtarë, neni 19 i ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikon se dy anëtarët nga radhët e avokatëve zgjidhen nga Kuvendi, pas verifikimit paraprak të plotësimit të kushteve ligjore, qëllim për të cilin krijohet një Komision i Pavarur *Ad Hoc*.

Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit nga avokatët që plotësojnë kriteret shpallet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në faqen zyrtare të Kuvendit, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të Avokatit të Popullit dhe në të paktën një gazetë me tirazhin më të lartë. Avokatët e interesuar e shprehin interesin e tyre nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Avokatit të Popullit. Jo më vonë se 2 ditë nga dita e paraqitjes së shprehjes së interesit dhe regjistrimit të kandidatëve, Avokati i Popullit i kërkon Dhomës Kombëtare të Avokatisë listën e avokatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë ligj. Pas përfundimit të afatit për shprehjen e interesit, Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* verifikon plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët dhe shpall emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit, të Kuvendit, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe i komunikon në mënyrë individuale secilit prej kandidatëve rezultatet e verifikimit të të dhënave.

Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* bën renditjen e kandidatëve në bazë të tërësisë së kriterëve profesionale dhe morale të përcaktuara në nenin 34 të ligjit dhe më pas i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit listën me dhjetë emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta. Ky i fundit kryen vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve, si dhe përgatit listën e kandidatëve fitues dhe listën e kandidatëve të cilët nuk plotësojnë kriteret ligjore të parashikuara në ligj. Jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës nga Sekretari i Përgjithshëm, komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision me 5 deputetë, 3 prej të cilëve caktohen nga radhët e shumicës parlamentare dhe 2 nga radhët e pakicës parlamentare, për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve. Nënkomisioni përzgjedh kandidatin për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor përmes një procedure votimi të hapur, ku votohet me radhë për të gjithë kandidatët sipas rendit alfabetik. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën 4 vota të anëtarëve të nënkomisionit do të konsiderohen të miratuar. Lista e kandidatëve të përzgjedhur i përcillet Kuvendit, i cili e miraton atë me dy të tretat e të gjithë anëtarëve.

Kuvendi zgjedh edhe një anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, me veprimtari në fushën e sistemit të drejtësisë ose të të drejtave të njeriut dhe që kanë zbatuar projekte në këto fusha të paktën 5 vitet e fundit, sikurse përcaktohet nenin 54 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Procedurat për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga shoqëria civile janë të ngjashme me ato të realizuara për përzgjedhjen e anëtarëve nga radhët e avokatëve dhe pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, të përshkruara më sipër.

Gjithashtu, Kuvendi zgjedh dy anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, të cilët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme, siç parashikohet në nenin 36 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Shpallja e vendeve vakante realizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme. Rektori i institucionit të arsimit të lartë që ka fakultet drejtësie dhe Drejtori i Shkollës së Magjistraturës shpallin thirrjet për paraqitjen e shprehjes së interesit nga anëtarët e personelit akademik dhe nga pedagogët e Shkollës së Magjistraturës që plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj, jo më vonë se 7 ditë nga shpallja e vendeve vakante. Pedagogët e interesuar i drejtojnë kërkesën me shkrim, sipas rastit, dekanit të fakultetit ose Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës. Brenda 7 ditëve nga mbyllja e afatit për dorëzimin e shprehjes së interesit, dekanati i fakultetit të drejtësisë mbledhet në një mbledhje të posaçme për të verifikuar plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët. Në përfundim të mbledhjes, dekani shpall listën e kandidatëve që përmbushin kriteret dhe ia përcjell atë rektorit. E njëjta procedurë realizohet edhe për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore nga kandidatët e Shkollës së Magjistraturës.

Jo më vonë se 80 ditë para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, dekani i secilit fakultet thërret mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik për të përzgjedhur kandidatët e atij fakulteti. Votimi për përzgjedhjen e kandidatëve nga asambleja është i fshehtë dhe individual. Për administrimin e procesit të votimit krijohet një komision votimi i përbërë nga anëtarë të personelit akademik që nuk kandidojnë. Në përfundim të këtij procesi përzgjidhen kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave.

Jo më vonë se 60 ditë para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit thërret një mbledhje të posaçme, në të cilën marrin pjesë Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, rektorët e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) që ofrojnë programe studimi në drejtësi dhe dekanët e fakulteteve të drejtësisë. Në mbledhje votohet për të gjithë kandidatët e përzgjedhur paraprakisht nga IAL dhe Shkolla e Magjistraturës. Në përfundim të procesit të votimit përzgjidhen 7 kandidatë nga IAL publike ose Shkolla e Magjistraturës dhe 3 kandidatë nga IAL jopublike që kanë marrë numrin më të madh të votave. Lista me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta në mbledhjen e posaçme, i përcillet Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Procedurat e mëtejshme të realizuara nga Kuvendi për përzgjedhjen e kandidatëve janë të njëjta me procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve nga radha e avokatëve.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka asnjë kompetencë dhe nuk ndërhyr në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të tij.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,